



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0430

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “K.S Dukagjini” SH.A kundër Vendimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit të Komunës Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve te Komunës se Prishtinës” me nr. Të Prokurimit: "616-24-2538-2-1-1" me 19/07/2024, mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “K.S Dukagjini” SH.A me nr. 2024/430, e datës 17.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve te Komunës se Prishtinës” Me Nr. Të Prokurimit: "616-24-2538-2-1-1" iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.
2. Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.03.2024, Komune e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve te Komunës se Prishtinës” Me Nr. Të Prokurimit: "616-24-2538-2-1-1". Ndërsa me datën 26.04.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “Kompania e Sigurimeve Eurosig” SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 175,000,00 euro.

Me 29.04.2024, OE “K.S Dukagjini”SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 07.05.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 17.05.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “K.S Dukagjini” SH.A. me nr. 430/24 lidhur me aktivitetin “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve te Komunës se Prishtinës” Me Nr. Të Prokurimit: "616-24-2538-2-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “K.S Dukagjini SH.A” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Pretendimi kryesorë ankimorë sipas ankesës nr.430/2024 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me kërkesën e dosjes së tenderit, OE ankues pretendon se kjo mungesë ka mund të sqarohet/plotësohet përmes sqarimeve shtesë në pajtim me dispozitat e LPP-së.

OE ankues po ashtu përmes kërkesës për rishqyrtim si dhe ankesës në OSHP ka ofruar deklaratën dhe emrat e stafit nga kompania VLLASA SHPK, mirëpo AK i ka konsideruar të pa pranueshme, sepse kjo kompani nuk është as pjesëmarrës e as pjesë e OE ankues.

Përgjigja e AK ne kërkesën për rishqyrtim :

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

OE K.S. Dukagjini SH.A.. ne kërkesën e DT. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2. Kapaciteti teknik dhe profesional, pika 3.KËRKESA : 3.Një Deklaratë që posedon staf profesional për kryerjen e shërbimeve për kontrollimin teknik të automjeteve si dhe numrin e punëtoreve,

DESHMIA: 3.Deklarata dhe lista e punëtoreve e nënshkruar e vulosur, OE K.S. Dukagjini SH.A. ne ofertën e tij nuk ka ofruar asnjë dëshmi për këtë kërkesë. Andaj është i papërgjegjshëm.

Nuk është aspak kontestues fakti që me dosjen e tenderit është kërkuar një deklaratë të vulosur dhe nënshkruar që posedon staf profesional për kryerjen e shërbimeve përkontrollimin teknik të automjeteve si dhe numrin e punëtorëve. Nga administrimi me ofertën e parashtruesit është gjetur se i njëjti me rastin e ofertimit nuk ka bashkangjitur edhe deklaratën e stafit sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Rrjedhimisht nuk e ka përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Sa i përket pikës së pretendimit se autoriteti kontraktues është dashur që të kërkoj sqarime shtesë për këtë fakt, duhet cekur se sqarimet shtesë në kuptim të nenit 72 të LPP, në rastin konkret do të mund të bëhejmbi bazën e një dokumenti që dorëzohet në emër të përmbushjes së një kërkesë të caktuar të dosjes së tenderit. Mirëpo parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë dokument për të përmbushur kërkesën në fjalë të dosjes së tenderit. Rrjedhimisht dorëzimi i dokumentit përkatës përmes sqarimeve në rastin konkret do të përbënte ndryshim substancial material të ofertës së dorëzuar që do të manifestohej si dokument i dorëzuar pas hapjes së ofertave dhe jo si dokument shtesë i kërkuar përmes sqarimeve në kuptim të nenit 72 të LPP. Sa i përket faktit që parashtruesi ka dorëzuar një deklaratë dhe një listë të punonjësve së bashku me kërkesën për rishqyrtim, duhet cekur se kjo listë dhe deklaratë nuk është fare në emër të parashtruesit por është në emër të kompanisë "Vllasa" Sh.P.K. me të cilën parashtruesi nuk ka tenderuar si grup i operatorëve ekonomik (pra "Vllasa" Sh.P.K. nuk është tenderues në këtë aktivitet të prokurimit). Kësisoj edhe po të ishte dorëzuar me rregull kjo deklaratë nga parashtruesi, sërish nuk do të kishte për tu përmbushur kërkesa e dosjes së tenderit pasi që OE "Vllasa" Sh.P.K. nuk është në garë për këtë aktivitet të prokurimit. Vlen të shtohet se parashtruesi së bashku me ofertën ka dorëzuar edhe një marrëveshje mes tij dhe "Vllasa" Sh.P.K. mirëpo kjo marrëveshje nuk është për themelimin e grupit të OE por as nuk i referohet aktivitetit përkatës të prokurimit me titull dhe nr. të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001 / 2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 21.05.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 430/2024, ndërsa me datë 11.06.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/430 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK-është Pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, si dhe OE pajtohet lidhur me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “K.S Dukagjini SH.A.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/430 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i pare (I) : Në cilësi të ekspertit shqyrtues ne kemi analizuar ofertën dhe sqarimet e ofruara nga OE ankues, dhe kemi gjetur se i njëjti ka ofruar deklaratë dhe listë të stafit nga kompania “Vllasa SH.P.K”.

Megjithatë njëjtë sikurse AK, edhe ne konsiderojmë se kjo është e papranueshme sepse kompania Vllasa nuk është pjesë e grupit të OE ankues, pasi OE ankues ka ofertuar si i vetëm , e po ashtu nuk është as i deklaruar si nënkontraktorë në formularin e dorëzimit të tenderit.

Konsiderojmë se OE ankues “K.S Dukagjini SHA” nuk mund të plotësojë kërkesat e dosjes me deklaratë dhe staf të një kompanie tjetër e cila as nuk është pjesë OE ankues, e as nuk është i deklaruar si nënkontraktor nga vet OE ankues.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të pabazuara dhe se vendimi i AK-së është në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj

fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues vlerësimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori këtë vendim me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret Paneli Shqyrtues duke u mbështetur në raportin e ekspertit shqyrtues pa nevojë që të njëjtat përgjigje të përsëriten prap dhe duke u bazuar në dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues duke ja falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës” Me Nr. Të Prokurimit: “616-24-2538-2-1-1”.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - K.S. Dukagjini SH.A.**
- Arkivës së OSHP-së: